



Republika e Kosovës * Republika Kosova * Republic of Kosovo
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
Regulatorna Komisija Javne Nabavke
Public Procurement Regulatory Commission



RAPORTI MBI AKTIVITETET E PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË PËR VITIN 2007

01 Janar 2007 - 31 Dhjetor 2007

Shkurt 2008
Prishtinë

P Ë R M B A J T J A

HYRJE	3
1. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.....	4
1.1. Bashkëpunimi i Krpp-së me Institucionet Ndërkombëtare të Prokurimit	5
1.2. Përkrahja e Krpp-së nga Agjencioni Evropian për Ri-ndërtim (AER)	6
1.3. Amandamenti i Ligjit për Prokurim Publik.....	9
2. Aktivitetet e Departamenteve të KRPP-së	12
2.1. Departamenti për Rregulla	13
2.2. Departamenti për Mbikëqyrje dhe Monitorim	15
2.3. Departamenti për Teknologji Informative dhe Statistika	18
2.4. Departamenti për Trajnime	20
3. Aktivitetet e Prokurimit Publik në Kosovë gjatë vitit 2007	22
3.1. Prokurimet Publike në raport me BPV në Kosovë gjatë vitit 2007	23
3.2. Prokurimet Publike sipas autoriteteve kontraktuese gjatë vitit 2007.....	24
3.3. Prokurimet Publike sipas burimeve të financimit gjatë vitit 2007.....	26
3.4. Prokurimet Publike sipas llojit të prokurimit gjatë vitit 2007	28
3.5. Prokurimet Publike sipas llojit të vlerës së prokurimit gjatë vitit 2007	30
3.6. Prokurimet Publike sipas procedurave të prokurimit	32
3.7. Prokurimet Publike sipas llojit dhe procedurave të prokurimit gjatë vitit 2007.....	34
3.8. Prokurimet Publike sipas vlerës së përlogaritur dhe vlerës së kontratës së shkruar gjatë vitit 2007	35
3.9. Kontratat e nënshkruara sipas prejardhjes së operatorve ekonomik gjatë vitit 2007	36
3.10. Kontratat e nënshkruara në Kosovë nga autoritetet kontraktuese gjatë vitit 2007	38
3.11. Autoritetet kontraktuese me vlerë të përgjithshme të kontratave të nënshkruara që e tejkalojnë vlerën 2.000.000,00 € gjatë vitit 2007	41
3.12. Kontratat e nënshkruara me vlerë mbi 2.000.000,00 € nga autoritetet kontraktuese gjatë vitit 2007	42
4. Shqyrtimi i ankesave të prokurimit	43
4.1. Shqyrtimi i ankesave të autoriteteve kontraktuese gjatë vitit 2007.....	44
4.2. Krahësimi i lëndëve të shqyrtuara gjatë vitit 2006 dhe 2007	46
4.3. Shqyrtimi i vendimeve të Agjencionit të Prokurimit Publik	47
5. Rekomandimet për përmirësimin e Sistemit të Prokurimit Publik në Kosovë.....	48
6. Aneks: Shpenzimet Buxhetore të KRPP-së për vitin 2007	49

H Y R J E

Duke u bazuar në Nenin 82.2 (i), të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës Nr. 02/L-99, të shpallur me Rregulloren Nr. 2007/20, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) për çdo vit kalendarik do të përgatisë dhe dorëzoj Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës Raportin Vjetor, në të cilin analizohen aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë, për atë vit kalendarik, së bashku me rekomandimet për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik, si dhe përmirësimin e Ligjit për Prokurim Publik sipas nevojës. Ky raport duhet t'i dërgohet Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës më së voni deri në fund të Shkurtit të vitit vijues.

Në bazë të kërkesës së cekur sipas Nenit të lartshënuar të LPP-së, KRPP-ja me kohë ka përgatitur Raportin vjetor për vitin 2007, dhe të njëjtin u'a dërgon Qeverisë së Kosovës, si dhe Kuvendit të Kosovës.

Ky raport pasqyron në pika të shkurtër punën vjetore të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, kurse një analizë më e gjërsishme dhe më e detajizuar i është bërë aktiviteteve të prokurimit publik në Kosovë, në bazë të kërkesës së Ligjit për Prokurim Publik të amandamentuar brenda periudhës: nga data 01 Janar 2007 deri 31 Dhjetor 2007.

Në këtë raport janë përfshirë aktivitetet e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, duke paraqitur aktivitetet e secilit Departament të KRPP-së, me përqëndrim të veçantë në një analizë të detajizuar të gjitha aktiviteteve të prokurimit në Kosovë të zhvilluara gjatë vitit 2007. Pasi që gjatë vitit 2007 nga Kuvendi i Kosovës është amandamentuar Ligji për Prokurim Publik, ky raport është përgatitur në përputhje me kërkesat që dalin nga Ligji i amandamentuar.

Është ky viti i tretë që KRPP-ja përgatitë një raport të tillë, duke u mundaar që për çdo vit ta avancoj, dhe ta kompletoj sa më shumë që të jetë e mundur, me qëllim që Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës, ta kenë një pasqyrë më të plotë mbi të gjitha aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë të zhvilluara gjatë vitit 2007. Ky raport do të jetë mjaftë i mirëseardhur edhe për të gjitha institucionet financiare monetare ndërkombëtare që operojnë në Kosovë, sepse për herë të parë do të kenë në dispozicion një material të tillë në të cilin përfshihen aktivitet e prokurimit publik në Kosovë sipas burimeve të financimit, vlerave të kontratave të prokurimit, llojeve të aktiviteteve të prokurimit, si dhe procedurave të prokurimit. Raporti do të jetë i dobishëm edhe për donatorët e ndryshëm që mendojnë të investojnë në të ardhmen në Kosovë, pasi që mund të konstatohet se 80,93 % të buxhetit për prokurime publike në Kosove gjatë vitit 2007 janë shpenzuar përmes procedurave të hapura, që njihen si procedurat më transparente.

1. KOMISIONI RREGULLATIV I PROKURIMIT PUBLIK

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik i Kosovës është themeluar duke u bazuar në nenin 81 të Ligjit për Prokurim Publik Nr. 2003/17, i cili ka hyrë në fuqi më 09 Qershor 2004. KRPP-ja ka filluar të funksionojë më 03 Shkurt të vitit 2005. Me amandamentimin e Ligjit për Prokurim Publik, nga ana e Kuvendit të Kosovës më 08 Shkurt 2007, të shpallur nga PSSP-ja më 06 Qershor 2007, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik ndryshojnë duke iu përshtatur kërkesave që dalin nga dy Direktivat e Prokurimit të BE-së Nr. 2004/17 dhe 2004/18, si dhe rrethanave që kanë ndodhur në Kosovë në fushën e prokurimit publik gjatë periudhës 2004-2006.

Sipas Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës të amandamentuar, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik :

- Është përgjegjës për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik në Kosovë;
- Vendosë rregulla të hollësishme për të siguruar zbatimin adekuat të LPP-së;
- Nxjerrë dhe publikon interpretime me shkrim, si dhe ofron ndihmë teknike dhe këshilla autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik për zbatimin e dispozitave të LPP-së;
- Krijon dhe mirëmban faqen informative në internet që i ofron publikut qasje të pakufizuar në të dhënat mbi prokurimin publik në Kosovë, si dhe mundëson përmirësimin e publikimeve të kërkuara sipas LPP-së;
- Mbështet IKAP-in dhe autoritetet tjera publike të trajnimit dhe arsimimit për të siguruar trajnimin dhe aftësimin e zyrtarëve të prokurimit publik në tërë Kosovën;
- Të fillojë dhe mbështesë zhvillimin e prokurimit elektronik dhe komunikimin brenda fushës së prokurimit publik;
- Të grumbulloj, analizoj dhe publikoj informacionet për procedurat e prokurimit publik dhe të gjitha kontratat publike të dhëna në Kosovë;
- Bashkëpunon me organizatat tjera brenda dhe jashtë vendit për çështjet që lidhen me prokurimin publik;
- Propozon Qeverisë dhe Kuvendit masat për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik, dhe përmirësimin e këtij Ligji;

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik udhëhiqet nga Bordi i cili përbëhet prej pesë anëtarëve, të cilët propozohen nga Qeveria dhe emërohen nga Kuvendi i Kosovës. Me amandamentimet e bëra në LPP parashihet që në ardhmen Bordi i KRPP-së të ketë 3 anëtarë të përhershëm, kurse çdo anëtar i KRPP-së që është në detyrë që prej 31 Dhjetorit 2006 do të vazhdojë të shërbejë në atë detyrë deri në mbarimin e mandatit të tij, siç parashikohet në legjislacionin e prokurimit që ishte në fuqi në kohën e emërimit të tij.

1.1. BASHKËPUNIMI I KRPP-së ME INSTITUCIONET NDËRKOMBËTARE TË PROKURIMIT

Sa i përket bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare të prokurimit, si dhe me vendet e regjionit dhe ato të BE-së, KRPP-ja gjatë vitit 2007 ka zhvilluar një aktivitet mjaftë të frytshëm. Pasi që Kosova më herët është anëtarësuar në Rrjetin e Prokurimit Publik në Evropë, delegacioni nga Kosova mori pjesë në Prill 2007 në konferencën vjetore mbi Rrjetin e Prokurimit Publik në Evropë e cila u mbajtë në Warshava të Polonisë. Në Konferencën mbi Reformimin e Sistemit të Prokurimit Publik në vendet e Ballkanit Perëndimor të mbajtur në Maj të vitit 2007 në Dubrovnik mori pjesë edhe delegacioni nga Kosova i cili përbëhej nga tre anëtarë të Bordit të KRPP-së, Tema e trajtuar në këtë konferencë kishte të bënte me Shqyrtimin e ankesave në prokurimin publik dhe trajtimi i tyre ligjor.

Në Konferencën me karakter euroipan të mbajtur mbi koncesionet në Shtator 2007 në Sofje të Bullgarisë mori pjesë edhe delegacioni nga Kosova.

Një bashkëpunim mjaftë të ngushtë ka vazhduar me Institutin “SIGMA” në Paris, i cili nga Organizata Evropiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), është angazhuar për mbikëqyrjen e Reformimit të Sistemit të Prokurimit Publik në vendet e Ballkanit Perëndimor gjatë fazës së tranzicionit, si dhe me Sektorin për Politikën e Prokurimit Publik në kuadër të Komisionit Evropian me seli në Bruksel.

Gjatë Tetorit 2007, delegacioni i institucioneve të prokurimit publik të Kosovës ka mbajtur takim pune në Paris me udhëheqësit më të lartë të këtij Instituti dhe përveç informimit mbi të arriturat në prokurimin publik në Kosovë, është arritur pajtueshmëria në mes të KRPP-së, APP-së dhe SIGMA-s (Paris) që më 16 dhe 17 Shtator 2008 të mbahet në Kosovë konferenca vjetore mbi prokurimin publik në vendet e Ballkanit Perëndimor. Temë bosht e konferencës do të jetë implementimi i suksesshëm i legjislacionit për prokurim publik, si dhe funksionimi i zyrave qendrore të prokurimit publik në vendet e Ballkanit Perëndimor. Është kjo konferenca e parë e këtij lloji që do të mbahet në Kosovë, kurse pjesëmarrës do të jenë përfaqësuesit e Komisionit Evropian, të OCDE/SIGMA, të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, si dhe përfaqësuesit e më shumë se dhjetë vendeve tjera të Evropës me të cilat institucionet e prokurimit publik të Kosovës kanë raporte të mira bashkëpunimi. Gjatë konferencës do të bëhet prezenimi mbi zhvillimet e fundit në fushën e prokurimit publik në gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor.

Në Konferencën vjetore regjionale ballkanike mbi koncesionet e cila u mbajtë në dhjetor 2007, në Tiranë, nga ana e delegacionit të Kosovës u paraqitën ecuritë në implementimin e legjislacionit në fushën e koncesioneve në Kosovë.

1.2. PËRKRAHJA E KRPP-së NGA AGJENCIONI EVROPIAN PËR RI-NDËRTIM (AER)

Gjatë vitit 2005, nga ana e AER-it është zgjedhur Kompania konsulente “Fineurope SpA” nga Milano –Itali, për Asistencë Teknike në Reformimin e Sistemit të Prokurimit Publik në Kosovë. Projekti ka filluar më 22. 11. 2005 dhe sipas kontratës është paraparë të zgjasë 18 muaj – deri më 21.05.2007. Gjatë muajit Maj 2007, në mes të AER-it dhe Kompanisë konsulente është vazhduar kontrata edhe për katër muaj shtesë – deri më 21.09.2007

Institucionet përfituese kryesore të këtij projekti janë: Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik dhe Agjencia e Prokurimit Publik.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është:

- Të promovoj efikasitetin dhe efektivitetin në përdorimin e fondeve publike si dhe të kontribuoj në zvogëlimin e mundësive për mashtrim, korrupsion dhe keqpërdorim të fondeve publike të Kosovës.

Objektivat specifike të projektit janë:

- Të krijoj një kornizë ligjore për funksionimin e sistemit konkurrues të prokurimit publik, në pajtim me legjislacionin e BE-së;
- Të krijoj një kornizë institucionale moderne dhe transparente të prokurimit publik, në pajtim me legjislacionin e BE-së;
- Të rrisë qasjen në informacione lidhur me tenderët publik dhe në përgjithësi lidhur me prokurimin publik; dhe
- Të ngrisë vetëdijen dhe njohuritë në mesin e autoriteteve kontraktuese, operatorëve ekonomik, institucioneve të prokurimit publik dhe publikut të gjërë.

Me datën 28.09.2007, Bordi i KRPP-së ka diskutuar mbi raportin përfundimtar të punës së Projektit për RSPP në Kosovë, dhe pas diskutimeve të gjërsishme mbi ndihmën që ka pranuar nga kompania konsulente “Fineurope SpA”, në të katër Departamentet të cilat funksionojnë në kuadër të KRPP-së, ka nxjerrë këto konkluzione, duke pasur parasysh objektivat specifike të projektit.

Lidhur me objektiven - “Krijimin e një kornize ligjore për funksionimin e sistemit konkurrues të prokurimit publik në Kosovë, në pajtim me legjislacionin e BE-së”, Bordi i KRPP-së mendon se kompania konsulente “Fineurope SpA”, ka ofruar një ndihmë të konsiderueshme rreth amandamentimit të Ligjit për Prokurim Publik. Me ndihmën e kompanisë konsulente është finalizuar amandamentimi i LPP-së i cili është aprovuar nga Kuvendi i Kosovës më 08 Shkurt 2007, kurse ka hyrë në fuqi me 06.06.2007 pas shpalljes nga PSSP-ja.

Sa i përket Legjislacionit dytësor, në fillim të projektit janë bërë korrigjimet dhe evitimet e lëshimeve në përkthimin e legjislacionit dytësor të përgatitur gjatë fazës së parë nga “Confirmec”. Mirëpo, duke parë që legjislacioni dytësor i hartuar në bazë të LPP-së është kompleks dhe jo shumë praktik për zbatim për shkak të volumit fizik, Bordi i KRPP-së në marrëveshje me AER-in, dhe kompaninë konsulente “Fineurope SpA” janë pajtuar që të thjeshtësohen këto dokumente dytësore me qëllim të zbatimit më të lehtë në praktikë.

Nga ana e ekipit të projektit, më 30.03.2007, i është dorëzuar KRPP-së në gjuhën angleze pakoja e përpunuar e legjislacionit dytësor mbi prokurimin në formë të draftit, i bazuar në Ligjin e amandamentuar nga Kuvendi i Kosovës para se ai të shpallet nga PSSP-ja.

Pakoja e legjislacionit dytësor e përkthyer në gjuhën shqipe nga ekipi i projektit për herë të parë është dorëzuar KRPP-së më 29.05.2007. Duke vërejtur se koha e cila kishte mbetur deri në përfundim të projektit ishte mjaftë e shkurtër, Bordi i KRPP-së formoi fokus grupin prej shtatë anëtarëve-ekspert të prokurimit, me ç'rast të njëjtit ia caktoj si detyrë që të merret me analizën dhe shikimin e pakos së legjislacionit dytësorë me qëllim të dhënies së sugjerimeve, vërtetëjeve, propozimeve dhe komenteve eventuale rreth këtij legjislacioni. Fokus grupi bëri shikimin e pakos së legjislacionit dytësorë me ç'rast pas rishikimit ka hartuar dhe përgatitur procesverbalin me shkrim prej 19 faqeve në të cilin ka prezantuar të gjitha vërejtjet, sugjerimet, propozimet dhe komentet që kanë pasur të bëjnë me legjislacionin dytësorë dhe të njëjtin procesverbal ia ka dërguar ekipit të projektit. Ekipi i projektit me datën 19.09.2007 ka dorëzuar pakot e rishikuara me legjislacionin dytësorë në të tri gjuhët, vetëm një ditë para mbajtjes së takimit përfundimtar të Komitetit drejtues të projektit. Prej momentit të dorëzimit të këtyre pakove me legjislacion dytësorë deri në momentin kur është caktuar që të mbahet mbledhja e fundit e komitetit drejtues objektivisht ka qenë e pa mundur për të bërë shikimin e këtyre dokumenteve dhe për të dhënë ndonjë vlerësim nga ana e KRPP-së, për arsye se volumi i pakove, rregulloreve, udhëzuesve si dhe i formularëve standard është bukur voluminoz dhe për kryerjen e një pune të tillë është e domosdoshme një kohë objektivisht e pranueshme.

Megjithatë brenda kësaj kohe edhe pse të shkurt përfaqësuesit e KRPP-së kanë bërë përpjekje që të rishikojnë aq sa ka qenë e mundur pjesë të ndryshme të legjislacionit dytësorë me ç'rast ka konstatuar se në pakot e legjislacionit dytësor nuk janë kompletuar me aktet dytësore si në vijim:

1. Regjistri mbi përmbajtjen e legjislacionit dytësorë që duhet të punohet
2. Regjistri mbi përmbajtjen e draft legjislacionit dytësor të finalizuar;
3. Regjistri i pjesëve nga legjislacioni dytësorë që nuk janë punuar;

Pjesa D – Rregullat për procedurat e shqyrtimit (“file i zbrazët – nuk është punuar asgjë lidhur me këto rregulla”);

Pjesa E – Formularët standard dhe dosjet e tenderit.
Nga kjo pjesë nuk janë punuar aktet dytësore si në vijim;

1. Instruksioni për leximin e Ligjit (2003/17 i amandamentuar me rregulloren 2007/20);
2. Udhëzuesi për përdorimin e dosjeve të tenderit;
3. Instruksioni mbi shfrytëzimin e rregullores së Prokurimit Publik;
4. Njoftimi për dhënie të kontratës për gazetë;
5. Formularë standard për planifikimin e Prokurimit ;
6. Udhëzues për blerjet me vlerë minimale nën 1000 €;
7. Udhëzues për kontratë kornizë;
8. Deklarata nën betim për zyrtarë të Prokurimit

9. Deklarata nën betim për anëtarët e komisionit vlerësues të caktuar nga autoriteti kontraktues
10. Deklarata nën betim për anëtarët e bordit dhe personelin e KRPP-së, OSHP-së dhe APP-së
11. Udhëzues për themelimin e departamentit të Prokurimit

Që nga data 27.04.2006 e hyrjes në fuqi të Ligjit për Procedurën e Dhënies së Koncesioneve, Nr 02/L -44, me nenin 51 të këtij Ligji, KRPP-ja obligohet të siguroj zbatimin e këtij Ligji. Për këtë qëllim KRPP-ja ka për detyrë të nxjerr rregulla dhe akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji. Meqenëse KRPP-ja është e ngarkuar edhe me këtë kompetencë sipas këtij ligji, ka kërkuar nga kompania konsulente “Fine Europe” që të bëjë edhe draftimin e legjislacionit dytësorë të këtij ligji, por kompania në fjalë nuk ka punuar asgjë në këtë drejtim.

Mendimi i bordit të KRPP-së është se edhe Draft - Legjislacioni dytësor i përpunuar dhe i dorëzuar në KRPP- është ende mjaftë voluminoz dhe paraqet vështirësi për zbatim në praktik.

Në takimin përfundimtar të Komitetit drejtues të projektit për RSSP, të mbajtur më 20.09.2007 në të cilin kanë prezantuar tre nga katër anëtarët e Komitetit drejtues të projektit me të drejtë vote (KRPP, AER, APP), disa nga përfituesit tjerë të projektit, si dhe ekipi i Kompanisë Konsulente, i cili ka prezantuar Raportin përfundimtar të Ekipit të projektit i cili mbulon edhe kohën shtesë, pas diskutimeve të shumta nga të gjithë përfaqësuesit e Komitetit drejtues të Projektit rezultuan këto qëndrime :

a) Nga Komponenti i parë aprovohet pjesa që ka të bëjë me ligjin e amandamentuar të prokurimit publik , kurse nuk aprovohet pjesa që ka të bëjë me Legjislacionin dytësor të prokurimit, pasi që edhe nuk është kompletuar në tërësi, si dhe ende është mjaftë i gjër dhe voluminoz për zbatim në praktikë. Me rastin e votimit përfaqësuesit e AER-it mbajtën qëndrim neutral duke dhënë arsyetimin se ende nuk kanë pasur rast ta kenë në dispozicion legjislacionin dytësor mbi prokurimin.

b) Lidhur me objektiven e dytë: “Krijimin e një kornizë institucionale moderne dhe transparente të prokurimit publik, në pajtim me legjislacionin e BE-së”, Bordi i KRPP-së mendon se janë bërë hapa të rëndësishëm në këtë drejtim, pasi që në bashkëpunim të ngushtë në mes të kompanisë konsulente, me KRPP-në dhe IKAP-in, janë trajnuar dhe çertifikuar 40 trajnerë të prokurimit siç është paraparë me projekt. Nga këta trajner rreth 15% janë nga radhët e minoriteteve të Kosovës. Ky grup i trajnerëve pritet që në vitet e ardhshme të bartë barrën kryesore në trajnimin e zyrtarëve të prokurimit nëpër tërë territorin e Kosovës.

c) Lidhur me objektiven e tretë: “Rritja e qasjes në informacione lidhur me tenderët publik dhe në përgjithësi lidhur me prokurimin publik” duke dizajnuar dhe zhvilluar një ueb-faqe për KRPP-në, për të cilën Bordi i KRPP-së mendon se është me rëndësi jetike për funksionim normal të sistemit të prokurimit publik në Kosovë, në fillim të projektit janë paraqitur vështirësi të theksuara për arsye të ndërrimit të disa ekspertëve ndërkombëtar për këtë fushë. Por që nga 01 Janari 2007 me ardhjen e ekspertit të tretë të IT-së janë shënuar rezultate të theksuara në këtë komponentë dhe ueb-faqja zyrtare për prokurim publik në kuadër të KRPP-së është dizajnuar, dhe është zyrtarizuar për funksionim sipas kërkesave të LPP-së..

d) Lidhur me objektiven e katërt: “Ngritja e vetëdijes dhe njohurive në mesin e autoriteteve kontraktuese, operatorëve ekonomik, institucioneve të prokurimit publik dhe publikut të gjerë”, Bordi i KRPP-së pas shqyrtimit të situatës lidhur me këtë çështje erdhi në përfundim se Kompania konsulente ka bërë të gjitha angazhimet për zhvillimin e kësaj komponente, si dhe përgatitjen dhe botimin e fletushkës në të cilën përfshihen informacione relevante mbi prokurimin publik në Kosovë, por papritmas puna në këtë komponentë është ndërprerë. Edhe pas përfundimit të periudhës sa projekti ishte në fuqi, në këtë komponentë nuk ka ndonjë rezultat konkret.

Bordi i KRPP-së, mendon se një vështirësi e veçantë e cila e ka përcjellë projektin që nga fillimi i punës, deri në përfundim të projektit, ka qenë lëvizja dhe ndërrimi i shpeshtë i ekspertëve ndërkombëtar nëpër disa fusha.

1.3. AMANDAMENTIMI I LIGJIT PËR PROKURIM PUBLIK

Ligji për Prokurim Publik Nr. 2003/17, edhe pse ka pas shumë tipare të përbashkëta me ligjet dhe sistemet tjera që janë përgjithësisht të pranura dhe sigurojnë nivelin e kërkuar të efikasitetit transparencës dhe konkurrencës, siç janë Direktivat e Prokurimit të Komisionit Evropian, si dhe shumica e ligjeve të prokurimit të shteteve të BE-së, pas analizave të shumta dhe kontakteve të vazhdueshme me autoritetet kontraktuese, ndërmarrjet publike dhe operatorët ekonomik, është krijuar perceptimi i një ligji shumë kompleks, prandaj edhe nuk ka mund të implementohet në mënyrën e duhur sepse ka qenë i vështirë të kuptohet dhe si rezultat i kësaj, nuk janë arrit kursimet e pritura financiare, gjë që ishte edhe qëllimi kryesor i këtij ligji.

Duke pas parasysh faktin se zbatimi i Ligjit për Prokurimin Publik, është penguar nga kompleksiteti i tij, atëherë KRPP-ja me përkrahjen e kompanisë konsulente “Fine Europe SpA” ka marrë iniciativën për thjeshtimin e LPP-2003/17, në mënyrë që ligji të jetë më i kuptueshëm dhe më i zbatueshëm, dhe nga zbatimi i drejtë i tij të arrihen rezultatet edhe në efikasitetin e aktiviteteve të prokurimit, edhe në kursimet e konsiderueshme financiare gjatë kryerjes së aktiviteteve të prokurimit.

Prandaj, ka qenë e detyrueshme për mirëqenie financiare të Kosovës që të sigurohet reformimi i sistemit të prokurimit publik në Kosovë. Ky reformim është arritur me amandamentimin e Ligjit për Prokurimin Publik. Edhe pse në këtë ligj, janë ri-formuluar më thjeshtë dhe më qartë disa nga dispozitat e tij esenciale, KRPP-ja konsideronë se ende ka mbet punë pa u bërë dhe si rezultat i kësaj, ende ka mbet hapësirë për shmangie dhe mos implementim të duhur të këtij ligji. Për këtë arsye duhet që sa më shpejtë të kompletohet legjislacioni përkatës dytësor për implementimin e LPP-së.

Amandamentimi i propozuar në Ligjin për Prokurim Publik Nr.2003/17, i pregaditur nga Grupi punues i formuar nga Zyra e Kryeministrit të Kosovës, pas shqyrtimeve paraprake në bazë të procedurave që kërkojnë sipas Rregullores së punës së Qeverisë së Kosovës dhe të Kuvendit të Kosovës, u aprovuan në formë të finalizuar me datë 08 Shkurt 2007 nga Kuvendi i Kosovës. Ky amandamentim është nënshkruar dhe shpallur nga PSPP-ja më 06 Qershor 2007, nga e cila ditë edhe ka hyrë në fuqi.

Arsyet për të cilat është paraqitur nevoja e amandamentimit të Ligjit të prokurimit Publik në Kosovë (LPP), qëndrojnë kërkesat që dalin nga dy Direktivat e fundit mbi

Prokurimin të BE-së, si dhe në krijimin e institucioneve të reja dhe në aprovimin e Ligjeve tjera (pas LPP-2003/17) nga Kuvendi i Kosovës, të cilat tani mbulojnë shumë fusha të cilat më parë ishin të mbuluara me Ligjin për Prokurimit Publik, siç janë:

- a) Fusha e koncesioneve nuk ka qenë e rregulluar me asnjë ligj tjetër, prandaj derisa të pregaditet dhe shpallet një ligj i tillë, koncesionet janë mbuluar me ligjin për prokurim publik.
- b) Ligji mbi procedurat e dhënies së Koncesioneve është aprovuar nga Kuvendi i Kosovës me 3 tetor 2005, prandaj me rastin e amendamentimit të LPP-së, kapitulli i cili ka rregulluar fushën mbi koncesionet është larguar nga LPP-ja.
- c) Trajnimi për prokurim, për Zyrtarët kosovar të Prokurimit sipas LPP-së, ka qenë kompetencë e KRPP-së. Pas themelimit të Institutit Kosovar për Administratë Publike (IKAP), me amendamentim është paraparë që trajnimin për prokurim të këtyre zyrtarëve ta bëjë IKAP-i duke u mbështetur nga KRPP-ja.
- d) Auditimet e aktiviteteve të prokurimit sipas LPP-së, janë autorizuar të kryhen nga KRPP-ja. Pas themelimit të Zyrës së Auditorit Gjeneral të Kosovës, me amendamentim të LPP-së, është paraparë që auditimet e aktiviteteve të prokurimit të largohen nga LPP-ja dhe të kalojnë në kompetencë të Zyrës së Auditorit Gjeneral të Kosovës.

Amandamentimi i LPP-së ka për qëllim:

- a) Të reformojë strukturën institucionale të prokurimit publik në nivel qendror, në bazë të kërkesave që dalin nga Direktivat e Prokurimit Nr 17/2004, dhe 18/2004 të Komisionit Evropian;
- b) Dispozitat ekzistuese të LPP-së të thjeshtësohen si kusht për t'u kuptuar më lehtë;
- c) Afatet e tenderimit të shkurtohen me qëllim të kryerjes me efikasitet të aktiviteteve të prokurimit; si dhe
- d) Të largohen materialet e tepërta nga LPP-ja.

Me amendamentim të LPP-së janë arritur këto qëllime:

Reformimi i strukturës institucionale të prokurimit publik në Kosovë:

- a) Shuhet Komisioni i Rregullave për Prokurim Publik në Pjesën VII të LPP-së, dhe të gjitha kompetencat që ka pasur ky komision, barten në përgjegjësi të KRPP-së;
- b) Formohet një Organ i ri i pavarur i prokurimit, i cili i përgjigjet drejtpërdrejt Kuvendit të Kosovës, i quajtur Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), i cili do të merret me shqyrtimin e ankesave;
- c) Numri i anëtarëve të Bordit të KRPP-së zvogëlohet nga pesë anëtar në tre anëtar;
- d) Numri i anëtarëve të Bordit të APP-së zvogëlohet nga tre anëtar në një anëtar;

Largimi i materialeve të mbuluara me Ligje të tjera:

- a) Largohet pjesa e IV e LPP-së që ka të bëjë me Kontratat e punëve me Koncesion, pasi që nga Kuvendi i Kosovës është aprovuar Ligji për Procedurën e dhënies së Koncesioneve; dhe
- b) Dispozitat e LPP-së që trajtojnë qështjet financiare largohen, pasi që mbulohen me Ligjin mbi Menaxhimin e financave Publike.

Shpërndarja e kompetencave të Institucionet tjera të themeluara pas aprovimit të LPP-së:

- a) Trajnimi dhe certifikimi i Zyrtarëve kosovar të Prokurimit, bartet në Institutin Kosovar për Administratë Publike, i mbështetur nga KRPP-ja;
- b) Auditimi i aktiviteteve të Prokurimit mbetet përgjegjësi e Zyrës së Auditorit Gjeneral të Kosovës;

Gjatë implementimit, si dhe gjatë zbatimit në praktikë të Ligjit aktual të Prokurimit Publik, janë evidentuar vështirësitë në zbatimin praktik të disa dispozitave, prandaj Bordi i KRPP-së ka analizuar dhe ka shqyrtuar jo vetëm përvojat e Ekspertëve të Prokurimit të rekrutuar në KRPP por edhe të Zyrtarëve të Prokurimit të Autoriteteve Kontraktuese dhe ka arrit në konkludim se disa dispozita duhet të ndryshohen dhe të avancohen më tutje në funksion të zbatimit më të lehtë dhe më efikas të LPP-së si dhe me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe të ekonomizimit të fondeve publike.

Thjeshtësimi i disa Dispozitave të LPP-së:

- a) Shkurtohen të gjitha afatet e tenderimit, me qëllim të kryerjes sa më efikase të aktiviteteve të prokurimit;
- b) Numri i procedurave të prokurimit zvogëlohet nga shtatë në gjashtë procedura; dhe
- c) Procedurat e përgjithshme të kufizuara dhe procedurat e veqanta të kufizuara fuzionohen në një procedurë – Procedura e kufizuar.


Avancimet tjera të cilat janë bërë me amandamentimin e LPP-së kanë të bëjnë me këto çështje:

- Thjeshtësimi i Ligjit për Prokurim Publik, si dhe eliminimi i disa përsëritjeve në këtë ligj;
- Funksionet që i janë dhënë APP-së dhe MEF-it me ligjin aktual lidhur me nxjerrjen e legjislacionit dytësor janë bartur tërësisht te KRPP-ja;
- APP-së i mbesin funksionet për ushtrimin e Prokurimeve Qendrore të Konsoliduara , në bazë të kërkesës së Qeverisë së Kosovës;
- Komisioni i Rregullave i themeluar me nenet 94 – 98 të ligjit aktual eliminohet dhe funksionet e tij i barten KRPP-së;
- Organit për Shqyrtimin e Ankesave (OSHP) i jepet një pavarësi e plotë, duke u bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare mbi prokurimin, si dhe Direktivat mbi Prokurimin e BE-së;
- Autoriteteve Kontraktuese i jepet një pavarësi më e madhe për zgjedhjen e procedurave të prokurimit;
- Ngritët niveli i transparencës për çfarëdo monitorimi, trajnimi, nxjerrje të Rregulloreve dhe interpretimit të tyre, si dhe në marrjen e çfarëdo Vendimi për ankesat e parashtruara duke u kërkuar me ligj që publikimi i tyre të bëhet në faqen zyrtare të prokurimit publik në Kosovë.

2. AKTIVITETET E DEPARTAMENTEVE TË KRPP-së

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik të Kosovës, funksionin e vetë e kryen duke u bazuar në Pjesën e V të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës Nr. 02/L-99, si dhe në bazë të strukturës organizative të aprovuar më 23 Tetor 2007.

Struktura organizative e KRPP-së



*) Secili nga Departamentet e KRPP-së do ta mbulojë fushën e koncesioneve nga pjesa e vetë, sipas Ligjit për procedurën e dhënies së Koncesioneve- Rregullore Nr.2006/27

2.1. DEPARTAMENTI PËR RREGULLA

Bazuar në Nenin 82 të LPP-02/L-99, Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë, Departamenti i Rregullave për Prokurim Publik është i autorizuar të përpilojë rregulla detale për prokurimin publik për të siguruar zbatimin adekuat të këtij ligji. Këto rregulla përbëjnë legjislacionin dytësor, i cili ka vlerë aplikuese dhe detyruese sikurse edhe dispozitat e ligjit burimor.

Objektivë e përgjithshme e Departamentit të Rregullave është që të ngritë shkallën e përgjegjësisë së autoriteteve kontraktuese të cilat financohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, si dhe të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike dhe burimeve publike në Kosovë, në mënyrë që të zvogëlojë në masë të konsiderueshme mundësinë për mashtrim, korrupsion dhe keqëmenaxhim të fondeve publike.

Ndërsa objektivat e veçanta të Departamentit të Rregullave janë:

- Përpilimi i rregullave për prokurimin publik, dhe shpallja e tyre nga KRPP-ja;
- Ndryshimi dhe plotësimi i rregullave të aprovuara (nëse është e nevojshme);
- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me departamentet tjera të KRPP-së;
- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me autoritetet kontraktuese të Kosovës
- Kontrollimi analitik i kohëpaskohshëm me qëllim të verifikimit të realizimit të objektivave të parapara.

Viti 2007 është vlerësuar i suksesshëm, nga departamenti i rregullave ngase pjesa kryesore e legjislacionit dytësor është përgatitur në formë të draftit, dhe se 16 akte nënligjore janë aprovuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Këto dokumente dytësore janë përgatitur në tri versionet gjuhësore dhe kanë hyrë në fuqi me 01.01.2008.

Të gjitha autoritetet kontraktuese në Kosovë, kanë filluar së zbatuari, që nga data e hyrjes në fuqi të këtyre akteve dytësore. Deri më tani nuk ka pas asnjë vërejtje nga autoritetet kontraktuese lidhur me zbatimin e tyre, ose përmbajtjen e tyre.

Aktet dytësore të aprovuara nga KRPP-ja gjatë vitit 2007

Nr formularit	Versioni Gjuhësor		
	Në Gjuhën Shqipe	Në Gjuhën Angleze	Në Gjuhën Serbe
B1	Njoftimi paraprak	Indicative Notice	Obavestenje o nameri
B3	Njoftimi për kontratë	Contract Notice	Obavestenje o ugovoru
B3	Njoftimi për kontratë për gazetë	Contract notice for newspapers	Obavestenje o ugovoru za novine
B3	Njoftimi për konkursin e projektimit	Design Contest Notice	Obavestenje o konkursu za idejni projekat
B3	Njoftimi për konkursin e projektimit për gazetë	Design Contest Notice for Newspaper	Obavestenje o konkursu za idejni projekat za novine

B8	Njoftimi për dhënie të kontratës	Contract Award Notice	Obavestjenje o dodeli ugovora
B8	Njoftimi për dhënie të kontratës për gazetë	Contract Award Notice for Newspaper	Obavestjenje o dodeli ugovora za novine
B9	Njoftimi për rezultatet e konkursit të projektimit	Design Contest result notice	Obavestjenje o rezultatima konkursa za idejni projekat
B9	Njoftimi për rezultatet e konkursit të projektimit për gazetë	Design Contest result notice for Newspaper	Obavestjenje o rezultatima konkursa za idejni projekat za novine
B16	Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit	Cancellation notice	Obavestjenje o otkazivanju aktivnosti nabave
B16	Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit për gazetë	Cancellation notice for Newspaper	Obavestjenje o otkazivanju aktivnosti nabave za novine
B18	Raporti vjetor për kontratat e nënshkruara publike	Annual Report for public signed contracts	Godisnji izvestaj za potpisane javne ugovore
C	Kodi etik i prokurimit	Procurement Code of Ethics	Moralni Kod Nabavke
C1	Deklarata nën betim për zyrtarët e prokurimit	Declaration under oath for the procurement officers	Izjava pod zakletvom za sluzbenike nabavke
C2	Deklarata nën betim për anëtarët e komisionit vlerësues	Declaration under oath for the members of the evaluating committee	Izjava pod zakletvom za komisiju ocenjivanja
C3	Deklarata nën betim për punonjësit e KRPP-së, APP-së dhe OSHP-së	Declaration under oath for the employees of PPRC, PPA and PRB	Izjava pod zakletvom za radnike RKJN, AJN i TRN

Të gjitha aktet dytësore të lartcekura gjenden aktualisht në ueb-faqen e KRPP-së: www.ks.gov.net/krpp.

Gjatë vitit 2008 Departamenti për Rregulla, do të finalizojnë aktet tjera dytësore që janë duke u pregaditur konform ligjit Nr. 02/L-99, Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë.

2.2. DEPARTAMENTI PËR MBIKËQYRJE DHE MONITORIM

Me Ligjin për prokurim Publik në Kosovë të amendamentuar i cili ka hyre në fuqi me 06 Qershor 2007, Departamenti për mbikëqyrje dhe monitorim i KRPP-së ka detyrat dhe përgjegjësitë vijuese:

- Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës dhe të rregullave të prokurimit.
- Monitorimi i ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit publik lidhur me shkeljet eventuale të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës dhe të rregullave të prokurimit publik dhe të çfarëdo legjislacioni ose rregulle të mëparshme mbi prokurimin publik në Kosovë;
- Dhënia e rekomandimeve për avancimin e procesit të prokurimit publik nëpër Autoritete Kontraktuese, si dhe rekomandimet për avancimin e legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit

Departamenti për mbikëqyrje dhe monitorim i KRPP-së gjatë vitit 2007, ka kryer inspektime të plota të aktiviteteve të prokurimit sipas planit vjetor, inspektime sipas rastit, vëzhgime të hapjeve publike dhe interpretime të neneve të LPP-së për nevoja të autoriteteve kontraktuese apo të operatorëve ekonomik. Sipas nevojës personeli i Departamentit për mbikëqyrje dhe monitorim ka kryer edhe detyra tjera brenda përgjegjësisë së KRPP-së.

Në periudhën prej 01 Janar deri më 31 Dhjetor 2007, Departamenti për mbikëqyrje dhe monitorim ka kryer:

- 9 Inspektime të aktiviteteve të prokurimit të AK të parapara me planin vjetor
- 7 Inspektime të aktiviteteve të prokurimit sipas kërkesës
- 13 Vëzhgime të hapjes publike
- 3 Kërkesa për interpretim të LPP-së.

TABELA E INSPEKTIMEVE TË KRYERA SIPAS PLANIT VJETOR

Nr.	Autoriteti Kontraktues	Data e Vendimit	Data e dorëzimit të raportit
1	Kuvendi Komunal i Istogut	12.01.2007	30.01.2007
2	Kuvendi Komunal i Kamenicës	01.02.2007	12.02.2007
3	Kuvendi Komunal i Shtërpçës	11.08.2007	08.09.2007
4	Kuvendi Komunal i Malishevës	19.09.2007	06.11.2007
5	Radio Televizioni i Kosovës	08.03.2007	04.04.2007
6	Shërbimi Doganor i UNMIK-ut	25.05.2007	26.06.2007
7	Shkolla Policore në Vushtrri	13.07.2007	05.09.2007
8	Ministria e KRSQR	12.04.2007	07.05.2007
9	Kombinati "Trepça"-pjesa veriore	05.12.2007	25.01.2008

TABELA E INSPEKTIMEVE SIPAS KËRKESËS

	Autoriteti Kontraktues	Inspektimi	Data e kërkesës	Data e dorëzimit të raportit
1	Kuvendi Komunal i Gjakovës	Inspektim sipas Kërkesës-	11.10.2007	18.10.2007
2	Kuvendi Komunal i Pejës	Inspektim sipas Kërkesës	18.10.2007	08.11.2007
3	Korporata Energjetike e Kosovës	Inspektimi sipas kërkesës	28.02.2007	05.03.2007
4	Korporata Energjetike e Kosovës	Inspektimi sipas kërkesës	22.02.2007	26.02.2007
5	Korporata Energjetike e Kosovës	Inspektimi sipas kërkesës	03.08.2007	13.08.2007
6	Qendra Klinike Universitare	Inspektimi sipas kërkesës	15.10.2007	01.11.2007
7	Ministria e Ekonomisë dhe financave	Inspektimi sipas kërkesës	19.06.2007	25.06.2007

TABELA E VËZHGIMIT TË HAPJEVE PUBLIKE

Nr.	Autoriteti Kontraktues	Data e vëzhgimit	Data e dorëzimit të raportit
1	Mins. Arsm. Shkencës dhe Teknologjisë	18.10.2007	25.10.2007
2	Trupat Mbrojtëse të Kosovës	18.10.2007	29.10.2007
3	Ministria e Drejtësisë	18.10.2007	26.10.2007
4	Korporata Energjetike e Kosovës	07.11.2007	14.11.2007
5	Komisioni i Pavarur për miniera dhe minerale	13.12.2007	13.12.2007
6	Ministria e punëve të brendshme	08.11.2007	15.11.2007
7	Universiteti i Prishtinës	08.11.2007	14.11.2007
8	Shërbimi Doganor i UNMIK-ut	05.12.2007	11.12.2007
9	Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	10.12.2007	12.12.2007
10	Ministria e Shërbimeve Publike	04.12.2007	13.12.2007
11	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës	11.12.2007	03.01.2008
12	Shërbimi Policor i Kosovës	14.12.2007	28.12.2007

Gjatë kësaj periudhe edhe në inspektimet e parapara me planin vjetor edhe në ato sipas kërkesës, janë inspektuar dhe monitoruar më se 125 dosje të aktiviteteve të prokurimit të Autoriteteve Kontraktuese. Për të gjitha inspektimet e kryera Departamenti për mbikëqyrje dhe monitorim ka përgatitur raport me shkrim në të cilin janë paraqitur të gjitha shkeljet e konstatuara si dhe janë dhënë rekomandimet për eliminimin e këtyre shkeljeve të konstatuara. Nga tërë materiali i kontrolluar dhe i analizuar i dosjeve të aktiviteteve të prokurimit më së shumti ka pasur mos respektim të këtyre neneve:

1) Neni 7 i LPP-së , Planifikimi i aktiviteteve të prokurimit.

- 2) Neni 15.4 i LPP-së , Përcaktimi i qartë i kërkesave për tenderim dhe ndarja e kërkesave.
- 3) Neni 52.1 i LPP-së , Njoftimi i pjesëmarrësve për arsyet e eliminimit dhe njoftimit për dhënien e kontratës .
- 4) Neni 57 Ekzaminimi , vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve .
- 5) Neni 95.1 Përdorimi i drejt i formularëve standard të zyrtarizuar nga KRPP-ja.

Tabela e shkeljeve më të shpeshta të konstatuara nga Departamenti për Mbikëqyrje dhe Monitorim, si dhe rekomandimet për eliminimin e shkeljeve.

Neni i LPP-së	Përshkrimi i nenit	Numri i shkeljeve nga dosjet e kontrollu-ara	Arsyet e shkeljeve dhe rekomandimi i Departamentit të MM-së	
			Shkeljet e konstatuara gjatë kontrollit të dosjeve	Rekomandimi nga Departamenti i MM për Departamentin e Rregullave të KRPP-së
Neni 7	Planifikimi i prokurimit	22 -herë	Mungon kërkesa nga Njësia Kërkuese, Planifikim jo i plotë, Plotësimi jo adekuat i formularëve	Kërkesat e LPP-së janë të qarta Të respektohen dispozitat e LPP-së.
Neni 15.4	Llogaritja e vlerave të parashikuara të kontratave.	11- herë	Kërkesa për blerje jo mirë të definuara, sasia nuk është përcaktuar qartë, Është kërkuar vetëm çmimi (duhet të përcaktohet edhe sasia dhe vlera e përgjithshme e prokurimit).	Kërkesat e LPP-së janë të qarta Të respektohen dispozitat e LPP-së.
Neni 52.1	Njoftimi i kandidateve dhe tenderuesve të eliminuar .	24- herë	Nuk është bërë njoftimi në mjetet e informimit për kontratën e propozuar, Vlerësimi është majtë konfidencial.	Kërkesat e LPP-së janë të qarta Të respektohen dispozitat e LPP-së. Është bërë interpretimi zyrtar lidhur me mbajtjen e sekretit afarist KRPP-ja).
Neni 57	Ekzaminimi, Vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve	25- herë	Tender të pa kompletuar dhe të pa përgjegjshëm, Nën kritere jo të qarta, dhe të pa matshme, Gabime substanciale aritmetikore.	Kërkesat e LPP-së janë të qarta. Të respektohen dispozitat e LPP-së.
Neni 87A.1	Masat Zbatuese nga KRPP-ja	26- herë	Dosja e tenderit, Njoftimi për dhënien e kontratës, Raporti standard i vlerësimit, Formulari për dorëzimin e tenderëve, Formulari për pranimin e tenderëve, etj.	Kërkesat e LPP-së janë të qarta. Dokumenti standard (Dosja) është e ngarkuar me interpretim të LPP-së. Dosja e tenderit dhe të gjithë formularët e KRPP-së, duhet të thjeshtësohet për aq sa është e mundur.

2.3. DEPARTAMENTI PËR TEKNOLOGJI INFORMATIVE DHE STATISTIKA

Bazuar në Nenin 80.2.j, të Ligjit të amandamentuar për Prokurim Publik të Kosovës, KRPP-ja me përkrahjen e Agjencionit European për Rindërtim ka krijuar ueb-faqen zyrtare elektronike për prokurim publik në Kosovë : www.ks-gov.net/krpp . Në këtë ueb-faqe publikohen të gjitha llojet e njoftimeve që kanë të bëjnë me prokurimin publik në Kosovë. Me qellim që kjo ueb-faqe të udhëhiqet sa më mirë për përmbushjen e kërkesave ligjore, KRPP-ja ka themeluar Departamentin për Teknologji Informative dhe statistika për prokurim, i cili ka filluar të funksionoj prej muajit Gusht 2007.


Ky departament ka përgatitur dhe publikuar formën e re të formularit të raportit vjetor të kontratave të nënshkruara publike. Kjo ka mundësuar grumbullimin e raporteve vjetore në mënyrë elektronike nga 134 autoritete kontraktuese. Në bazë të raporteve vjetore të dërguara nga autoritetet kontraktuese, departamenti i TI-së ka përgatit raportin e përgjithshëm statistikor të prokurimeve publike të zhvilluara në Kosovë gjatë vitit 2007.

Është punuar në mënyrë sistematike dhe të kujdesëshme rreth harmonizimit dhe funksionimit të ueb-faqes sipas kërkesave të LPP-së. Është bërë trajnimi i nevojshëm i të gjithë zyrtarëve të prokurimit rreth ueb-faqes elektronike të prokurimit, ku tani vetë zyrtari i prokurimit ka filluar t'i regjistroj dhe përgatitë për publikim njoftimet për kontratë në mënyrë direkt nga vendi i tij i punës. Janë vendosur në ueb-faqe LPP i amandamentuar, legjislacioni sekondar, njoftimet rreth trajnimit të zyrtarëve të prokurimit, njoftime të ndryshme, përpunimi i Logos zyrtare të KRPP-së. Departamenti për TI ka krijuar rubrikat në ueb-faqe për publikimin e vendimeve të OSHP-së dhe APP-së.

Departamenti i TI-së pranë KRPP-së ka filluar të publikoj njoftimet për kontratë në ueb-faqen elektronike prej muajit Korrik 2007, të cilat po i paraqesim në tabelën 1 dhe grafikonet 1 dhe 2 në vazhdim.

Publikimi i njoftimeve ne ueb-faqen elektronike të KRPP-së : Korrik - Dhjetor 2007	
Lloji i njoftimeve	Nr. i njoftimeve të publikuara
Njoftim kontrate	1402
Njoftim për dhënie të kontratës	1001
Njoftim anulimi	488
Njoftim mbi konkurs projektimi	11
Njoftim mbi rezultatin e konkursit të Projektimit	11
Gjithsejtë :	2913

Tabela 1




Grafikoni 1

Siç shihet nga tabela 1 dhe grafikoni 1 , Njoftim për kontratë, numri i publikimeve është 1402 , derisa Njoftim për dhënie të kontratës 1001 , Njoftim anulimi 488 , Njoftim mbi konkurs projektimi 11 , si dhe Njoftim mbi rezultatin e konkursit të projektimit 11 .

Njoftimet e ndryshme nga autoritetet kontraktuese janë dërguar në mënyrë elektronike dhe janë kontrolluar dhe publikuar nga departamenti i TI-së për prokurim . Gjatë periudhës Korrik -Dhjetor 2007 në ueb-faqen zyrtare të prokurimit publik janë publikuar 2913 njoftime të gjitha llojeve.

Në grafikonin 2 , paraqitet numri i njoftimeve të publikuara në ueb-faqen e KRPP-së dhe diagrami i publikimeve gjatë këtyre muajve .



Grafikoni 2

2.4. DEPARTAMENTI PËR TRAJNIME


Konform nenit 23.1 të LPP-2003/17, KRPP-ja është kompetent që të zhvillojë dhe mundësoj së paku dy herë në vit një kurs për trajnim profesional për prokurim. Kursi i tillë do të përfshijë të gjitha aspektet materiale të LPP-së, dhe do të zgjasë së paku dhjetë ditë pune. Derisa sipas Ligjit paraprak mbi Prokurimin Publik, KRPP-ja ka qenë e autorizuar që të bëjë trajnimin e zyrtarëve kosovar të prokurimit, tani me amandamentimin e LPP-së i cili ka hyrë në fuqi me 06 Qershor 2007, kompetente për trajnimin e zyrtarëve që merren me prokurim publik është Instituti Kosovar për Administratë Publike në bashkëpunim me KRPP-në.

Trajnimet e organizuara gjatë gjysmës së parë të vitit 2007 janë mbajtur vetëm nga Departamenti për Trajnime i KRPP-së, kurse gjatë pjesës së dytë të vitit 2007 trajnimet për prokurim publik kanë vazhduar të mbahen në bashkëpunim të ngushtë me Institutin Kosovar për Administratë Publike të Kosovës. Nëse bëhet një karahasueshmëri e mënyrës së organizimit të trajnimeve para amandamentimit dhe pas amandamentimit të LPP-së, atëherë mund të konstatohet se trajnimet e organizuara në bashkëpunim me IKAP-in, kanë qenë më të dobishme dhe më të mirëseardhura për zyrtarët e prokurimit për arsye se paralelisht janë shfrytëzuar edhe potencialet profesionale KRPP-së, si dhe ato mbështetëse të IKAP-it.

Trajnimet në fushën e prokurimit publik të mbajtura gjatë vitit 2007, janë përqendruar në amandamentimin e Ligjit për Prokurim Publik, në mënyrën e funksionimit të faqes zyrtare të prokurimit publik të Kosovës, si dhe në mënyrën e plotësimit të dokumenteve standarde të prokurimit. Për këtë qëllim janë mbajtur dhjetë seanca trajnimi me nga shtatë grupe të vijuesve në gjuhën shqipe, si dhe dhjetë seanca tjera trajnimi me një grup të vijuesve në gjuhën serbe. Vijues të këtyre trajnimeve kanë qenë zyrtarët e prokurimit të gjitha autoriteteve kontraktuese të Kosovës, duke përfshirë institucionet qeveritare të Kosovës, kompanitë publike si dhe disa OJQ.

Gjatë Dhjetorit të vitit 2007, sipas kërkesave të LPP-së KRPP-ja në bashkëpunim me IKAP-in kanë organizuar testimin për të gjithë zyrtarët e prokurimit të cilët i kanë vijuar trajnimet. Testimin me sukses e kanë përfunduar gjithësejt 414 zyrtarë të prokurimit publik në Kosovë të cilët janë pajisur me certifikatë profesionale për prokurim publik. Nga gjithësejt 414 zyrtarët e certifikuar gjatë vitit 2007, 25 prej tyre ju takojnë minoriteteve, e që në përqindje paraqesin 6.04%, kurse nga numri i përgjithshëm i të certifikuarve 125 prej tyre i takojnë gjinisë femërore, apo shprehur në përqindje 31 %. Duke marrë para sysh se në Kosovë ekzistojnë 137 autoritete kontraktuese, atëherë për vitin 2008 në këto do të punojnë 414 zyrtarë të certifikuar për prokurim publik, e që do të thotë se mesatarja e zyrtarëve të certifikuar është 3.02 %, në krahasim me numrin e autoriteteve kontraktuese. Është ky viti i tretë që sipas kërkesave të LPP-së bëhet trajnimi dhe certifikimi i zyrtarëve kosovar të prokurimit publik të Kosovës. Nëse krahasohen ecuritë tri vjeçare që nga viti 2005, rreth trajnimit në fushën e prokurimit publik, atëherë mund të konstatohet se për çdo vit numri i zyrtarëve të trajnuar ka shënuar rritje. Gjersa në vitin 2005 ky numër ka qenë 302, në vitin 2006 është rritur në 360, kurse në vitin 2007 në 414.

Diagrami në vazhdim tregon numrin e zyrtarëve pjesëmarrës në trajnime dhe të certifikuar gjatë tri viteve të fundit (2005 -2007)



Sipas të dhënave të paraqitur në grafikun, gjatë vitit 2006 në krahasim me vitin 2005 numri i zyrtarëve të certifikuar është rritur për 58, apo shprehur në përqindje për 19 %, kurse gjatë vitit 2007 në krahasim me vitin 2006 numri i zyrtarëve të certifikuar është rritur për 54, apo shprehur në përqindje për 15 %.

3. AKTIVITETET E PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË GJATË VITIT 2007

Duke u bazuar në Nenin 82.2 (i), të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës Nr. 02/L-99, të shpallur me Rregulloren Nr. 2007/20, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik ka përgatitur për Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës Raportin Vjetor, në të cilin analizohen aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë, për vitin 2007 së bashku me rekomandimet për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik, si dhe përmirësimin e Ligjit për Prokurim Publik sipas nevojës.

